

VENDIM
Nr. 517, datë 13.6.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI DHE
ASFALTIMI I RRUGËVE KRYESORE TË QYTETIT TË BELSHIT, NË BASHKINË E
BELSHIT TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni dhe asfaltimi i rrugëve kryesore të qytetit të Belshit, në bashkinë e Belshit të qarkut të Elbasanit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Belshit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas masës përkatëse dhënë në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqet: 455,35 (katërqind e pesëdhjetë e pesë presje tridhjetë e pesë) m² truall, dhe 543,85 (pesëqind e dyzet e tre presje tetëdhjetë e pesë) m² objekt, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit prej 8 658 667 (tetë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga buxheti i bashkisë së Belshit, sipas planifikimit përkatës të kësaj bashkie.

5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Belshit.

7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Belshit për realizimin e këtij projekti.

8. Regjistrimi i ri i pasurive prej 455,35 (katërqind e pesëdhjetë e pesë presje tridhjetë e pesë) m² truall, dhe 543,85 (pesëqind e dyzet e tre presje tetëdhjetë e pesë) m², objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Belshit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Në proces”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë dorëzuar dokumentacionin e pronësisë, pranë bashkisë së Belshit. Deri në këtë çast, paratë të qëndrojnë të bllokuara në bankë.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Belshit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

